

MARRËVESHJA E MADRITIT PËR REGJISTRIM NDËRKOMBËTAR TË MARKAVE TREGTARE

**nga 14 prilli i vitit 1891, reviduar në Bruksel më 14 dhjetor të vitit 1900,
në Uashington më 2 qershor të vitit 1911, në Hagë më 6 nëntor të vitit 1925,
në Londër më 2 qershor të vitit 1934, në Nicë më 15 qershor të vitit 1957,
në Stokholm më 14 korrik të vitit 1967 dhe plotësuar më 28 shtator të vitit
1979**

Publikuar në “Gazetën Zyrtare të RM-së” nr. 2/74

Neni 1

1) Shtetet ku zbatohet kjo marrëveshje përbëjnë një Union të veçantë për regjistrim ndërkombëtar të markave tregtare.

2) Anëtarët e çdo shteti kontraktues mund të sigurojnë në të gjitha shtetet e tjera që janë pjesë e marrëveshjes mbrojtje të markave të tyre tregtare të cilat aplikohen në produkte apo shërbime, të regjistruara në vendin e origjinës, me regjistrimin e markave tregtare të përmendura në Byroja Ndërkombëtare për pronësi industriale (në tekstin e mëtutjeshëm: Byroja ndërkombëtare) nga Konventa për themelimin e Organizatës botërore për pronësi industriale (në tekstin e mëtutjeshëm: Organizata), që do të kryhet me ndërmjetësimin e administratës e vendit të origjinës.

3) Si vend i origjinës konsiderohet ai shtet i Unionit të veçantë ku i paraqituri ka ndërmarrje serioze tregtare apo industriale; nëse nuk ka ndërmarrje të tillë në ndonjërin nga shtetet e Unionit të veçantë, shteti i Unionit të veçantë në të cilin ka vendqëndrim; nëse nuk ka vendqëndrim në Unionin e veçantë, vendi i shtetësisë së tij nëse është shtetas i ndonjërit nga shtetet e Unionit të veçantë.

Neni 2

Pjesëtarët e shteteve të cilat nuk kanë aderuar në këtë Marrëveshje, e të cilët në territorin e Unionit të veçantë të formuar me këtë Marrëveshje i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 3 të Konventës së Parisit për mbrojtje të pronësisë industriale, janë të barabartë me anëtarët e shteteve nënshkruese.

Neni 3

1) Çdo paraqitje për regjistrim ndërkombëtar duhet patjetër të dërgohet në formularin e paraparë me Rregulloren për përmbardim; administrata e shtetit të origjinës së markës tregtare do të bëjë verifikimin se të dhënat në këtë fletëparaqitje janë të njëjta me të dhënat në regjistrin kombëtar dhe do ti shënojë datat dhe numrat e fletëparaqitjeve dhe regjistrimit në shtetin e origjinës, si dhe datën e fletëparaqitjes për regjistrim ndërkombëtar.

2) Paraqitësi është i obliguar që ti shënojë produktet apo shërbimet për të cilat kërkon mbrojtje të markës tregtare, si dhe, nëse është e mundur, klasën përkatëse apo klasat sipas klasifikimit institucional me marrëveshjen e Niqes për klasifikim ndërkombëtar të produkteve dhe shërbimeve për regjistrim të markave tregtare. Nëse paraqitësi nuk e bën këtë, Byroja ndërkombëtare do ti shpërndajë produktet apo shërbimet në klasa adekuate nga ky klasifikim. Byroja ndërkombëtare, bashkë me administratën kombëtare do të bëjë verifikimin e

shpërndarjes të cilin do ta shënojë paraqitësi. Në rast të mospërputhjes midis administratës kombëtare dhe Byrosë ndërkombëtare, vendimtar është mendimi i Byrosë ndërkombëtare.

3) Nëse paraqitësi kërkon që ngjyra të jetë element karakteristik i makës së tij tregtare, ai do të duhet:

1. që këtë ta deklarojë dhe në fletëparaqitjen e tij të bashkëngjisë vërejtje, duke shënuar edhe ngjyrën apo përbërjen e ngjyrave që i kërkon;

2. fletëparaqitjes të ia bashkëngjisë edhe mostrat me ngjyra të markës tregtare në fjalë, të cilat do të bashkëngjiten në lajmërimet deri te Byroja ndërkombëtare. Numri i mostrave do të vërtetohet me rregulloren për përmbarim.

4) Byroja ndërkombëtare menjëherë do të regjistrojë markat e paraqitura tregtare në pajtim me rregullat nga neni 1. Regjistrimi do ta mbajë datën e paraqitjes për regjistrim ndërkombëtar në shtetin e origjinës, nëse Byroja ndërkombëtare e pranon fletëparaqitjen në afat prej dy muajsh nga ajo datë. Nëse fletëparaqitja nuk është pranuar në atë afat, Byroja ndërkombëtare do ta shkruajë atë datë në të cilën e ka pranuar fletëparaqitjen. Byroja ndërkombëtare do ta publikojë atë regjistrim pa shtyrje në administratat e interesuara. Markat e regjistruara tregtare do të publikohen në një gazetë periodike, të cilën e publikon Byroja ndërkombëtare, në bazë të të dhënave nga fletëparaqitja për regjistrim. Për markat tregtare që përmbajnë ndonjë element figurativ apo zgjidhje të veçantë grafike, me rregulloren për përmbarim do të përcaktohet se a është i obliguar paraqitësi që të dërgojë bllok të printuar.

5) Për nevojat e publikimit të markave të regjistruara tregtare në shtetet nënshkruese, çdo administratë do të pranojë nga Byroja ndërkombëtare disa mostra falas dhe disa mostra me çmim të ulur të publikimit të lartpërmendur, proporcionalisht me numrin e njësive sipas dispozitave nga neni 16 paragrafi 4 nën a) nga Konventa e Parisit për mbrojtje të pronësisë industriale, nën kushtet e vërtetuara me rregulloren për përmbarim. Në të gjitha shtetet kontraktuese ky publikim do të konsiderohet si i mjaftueshëm dhe nga paraqitësi nuk do të kërkojë asgjë tjetër.

Neni 3 bis

1) Çdo shtet kontraktues mundet, në çdo kohë, me shkrim të njoftojë drejtorin gjeneral të Organizatës (në tekstin e mëtutjeshëm: drejtori gjeneral) se mbrojtja që del nga regjistrimi ndërkombëtar do të zbatohet në atë shtet vetëm nëse bartësi i të drejtës së markës tregtare shprehimisht e kërkon atë.

2) Ky njoftim hyn në fuqi gjashtë muaj pasi që drejtori gjeneral do ta ketë dërguar deri te shtetet kontraktuese.

Neni 3 ter

1) Kërkesa për zgjerim territorial të mbrojtjes e cila buron nga regjistrimi ndërkombëtar, ndaj shtetit i cili ka shfrytëzuar rastin nga neni 3 bis, duhet patjetër të theksohet në fletëparaqitjen nga neni 3 paragrafi 1.

2) Kërkesa për zgjerim territorial e dërguar pas regjistrimit ndërkombëtar duhet patjetër të dërgohet me ndërmjetësim të administratës kombëtare në formular të paraparë me rregulloren për përmbarim. Byroja ndërkombëtare do ta regjistrojë menjëherë dhe pa shtyrje për këtë do ti njoftojë administratat e interesuara apo administratën. Kjo do të publikohet në gazetën periodike të cilën e boton Byroja ndërkombëtare. Ky zgjerim territorial do të hyjë në fuqi atë ditë kur do të shkruhet në regjistrin ndërkombëtar, kurse do të pushojë të vlejë me pushimin e regjistrimit ndërkombëtar të markës tregtare për të cilën ka të bëjë.

Neni 4

1) Në bazë të regjistrimit të këtyre të publikuar pranë Byrosë ndërkombëtare, në pajtim me dispozitat e neneve 3 dhe 3 ter, mbrojtja e markës tregtare në secilin nga shtetet kontraktuese do të jetë e njëjtë sikur marka tregtare të jetë drejtpërsëdrejti e regjistruar në atë shtet. Shpërndarja e produkteve dhe shërbimeve e paraparë me nenin 3 nuk i obligon shtetet kontraktuese gjatë vlerësimit të vëllimit të mbrojtjes së markës tregtare.

2) Çdo markë tregtare që është lëndë e regjistrimit ndërkombëtar, do të gëzojë të drejtën e përparësisë, të themeluar me nenin 4 nga Konventa e Parisit për mbrojtje të pronësisë industriale, e prandaj nuk është e nevojshme që të plotësohen formalitetet nga pjesa D e atij neni.

Neni 4 bis

1) Nëse një markë tregtare veç më është regjistruar në një apo më shumë shtete kontraktuese, e më vonë përsëri është regjistruar në Byronë ndërkombëtare në emër të bartësit të njëjtë të të drejtës apo pranuesit të të drejtës së tij, do të konsiderohet se regjistrimi ndërkombëtar e zëvendëson regjistrimin e mëparshëm nacional, pa dëmtrim ndaj të drejtës së fituar me këtë regjistrim.

2) Administrata ndërkombëtare është e obliguar, në bazë të kërkesës, që ta shënojë në regjistrat e saj regjistrimin ndërkombëtar.

Neni 5

1) Në shtetet në të cilat legjislacioni i tyre këtë e lejon, administratat të cilat Byroja ndërkombëtare do ti njoftojë për një markë tregtare apo kërkesë për zgjerim

territorial të mbrojtjes në pajtim me nenin 3 bis, kanë mundësi që të deklarojnë se mbrojtja nuk mund ti miratohet asaj marke tregtare në territorin e tyre. Refuzimi i tillë mund të ndodhë vetëm nën kushtet të cilat do të zbatoheshin, në pajtim me Konventën e Parisit për mbrojtje të pronësisë industriale dhe gjatë regjistrimit të markës tregtare vendase. Megjithatë, mbrojtja nuk mund të refuzohet, madje as pjesërisht, nga arsye të cilat legjislacioni nacional do të aprovonte regjistrim vetëm për numër të kufizuar të klasave apo për numër të kufizuar të produkteve dhe shërbimeve.

2) Administratat të cilat dëshirojnë që ta shfrytëzojnë atë të drejtë, refuzimin duhet ta dërgojnë, duke theksuar edhe arsyet, deri te Byroja ndërkombëtare në afat të paraparë me legjislacionin e tyre nacional, e më së voni para skadimit të një viti, duke llogaritur nga dita e regjistrimit ndërkombëtar, respektivisht kërkesën për zgjerim territorial të dërguar sipas nenit 3 ter.

3) Byroja ndërkombëtare pa shtyrje do të dërgojë nga një kopje, dërgimi në këtë mënyrë i refuzimit deri te administrata e shtetit të origjinës dhe bartësit të të drejtës së markës tregtare apo përfaqësuesit të tij, nëse administrata e përmendur e ka caktuar deri te Byroja. Të interesuarit do të kenë mjete të njëjta ankuese sikurse fletëparaqitja për mbrojtje të markës tregtare të jetë dërguar nga vet ata drejtpërsëdrejti në shtetin në të cilin mbrojtja është refuzuar.

4) Byroja ndërkombëtare duhet patjetër ti njoftojë të interesuarit për arsyet e refuzimit, nëse kjo kërkohet nga ajo.

5) Administratat të cilat, për regjistrimin e ndonjë marke tregtare apo për kërkesë për zgjerim territorial të mbrojtjes, në afatin më të gjatë të lartpërmendur prej një viti nuk do ti dorëzojnë Byrosë ndërkombëtare asnjë vendim për refuzim të përkohshëm apo refuzim vendimtar, humbin të drejtën e mundësisë së paraparë me pikën 1 të këtij neni në raport me markën tregtare në fjalë.

6) Autoritetet kompetente nuk mund të miratojnë vendim për anulimin e markës tregtare ndërkombëtare nëse bartësit të të drejtës së markës tregtare nuk i mundësohet në kohë që ti mbrojnë të drejtat e tija. Për anulimin do të njoftohet Byroja ndërkombëtare.

Neni 5 bis

Mjetet dëshmuese për përdorim ligjor të elementeve të caktuara të cilat i përmbajnë markat tregtare, siç janë: armët, mburojat, portretet, shenjat e nderit, titujt, emrat tregtar apo emrat e personave përveç emrat e paraqitësit, apo mbishkrime të tjera të ngjashme, e të cilat mund të kërkohen nga ana e administratave të shteteve kontraktuese janë të liruara, përveç vërtetimit të administratës së shtetit të origjinës, nga çdo legalizim, si edhe nga çdo vërtetim tjetër.

Neni 5 ter

1) Byroja ndërkombëtare, do ti lëshojë secilit që kërkon, me pagesë të taksës së vërtetuar me rregulloren për përmbardim, transkripto të të dhënave të shkruara në regjistër të cilat kanë të bëjnë me markën e caktuar tregtare.

2) Byroja ndërkombëtare do të mund, gjithashtu, me pagesë, të kryejë hulumtim të përparësisë së markave tregtare ndërkombëtare.

3) Certifikatat nga regjistri ndërkombëtar, të kërkuara për shkak të paraqitjes në ndonjërin nga shtetet kontraktuese, janë të liruar nga çdo legalizim.

Neni 6

1) Regjistrimi i markës tregtare te Byroja ndërkombëtare bëhet për periudhë prej njëzet vjetësh, me mundësi për përtëritje nën kushtet e përcaktuara në nenin 7.

2) Pas skadimit të afatit prej pesë viteve, duke numëruar prej ditës së regjistrimit ndërkombëtar, ky regjistrim bëhet i pavarur nga marka tregtare më herët e regjistruar në shtetin e origjinës, me rezervën e përmbajtur në dispozitat në vijim.

3) Mbrojtja që del nga regjistrimi ndërkombëtar, pa marrë parasysh se a ka pasur bartje apo jo, nuk do të mund të thirret, në tërësi apo pjesërisht, nëse në afat prej pesë viteve nga regjistrimi ndërkombëtar, marka tregtare nacionale, paraprakisht e regjistruar në shtetin e origjinës në kuptimin e nenit 1, më nuk gëzon në tërësi apo pjesërisht mbrojtje ligjore në shtetin e vet. E njëjta është edhe në rastin kur kjo mbrojtje ligjore më vonë ka pushuar për shkak të padisë së ngritur para skadimit të afatit prej pesë viteve.

4) Në rast të fshirjes vullnetare apo fshirjes sipas detyrës zyrtare, administrata e shtetit të origjinës do të kërkojë fshirje të markës tregtare nga Byroja ndërkombëtare, e cila këtë edhe do ta bëjë. Në rast të mosmarrëveshjes, administrata në fjalë sipas detyrës zyrtare apo me kërkesë të paditësit, transkriptë nga padia apo nga ndonjë akt tjetër me të cilën ngritet mosmarrëveshja, si edhe vendimi përfundimtar. Byroja do të shkruajë vërejtje për këtë në regjistrin ndërkombëtar.

Neni 7

1) Regjistrimi çdo herë do të mund të përtërihet për periudhë prej njëzet viteve, duke numëruar prej skadimit të afatit paraprak, edhe atë me pagesën e taksës bazë, respektivisht taksave shtesë dhe shtesat e taksave të parapara me nenin 8 pika 2.

2) Gjatë publikimit nuk do të mund të kryhet asnjë ndryshim në raport me gjendjen e fundit nga interesimi paraprak.

3) Gjatë publikimit të parë, në pajtim me dispozitat e Aktit të Niqës nga 15 qershori i vitit 1957 apo dispozitat e këtij akti, duhet të theksohen klasat sipas klasifikimit ndërkombëtar për të cilën ka të bëjë regjistrimi.

4) Gjashtë muaj para skadimit të afatit për mbrojtje, Byroja ndërkombëtare me paralajmërim zyrtar do ta rikujtojë bartësin e të drejtës së markës tregtare dhe përfaqësuesin e tij për datën e saktë të skadimit të këtij afati.

5) Me pagimin e taksës së rritur të paraparë me rregullon për përmbarim, do të miratohet afati plotësues prej gjashtë muajsh për përtëritjen e regjistrimit ndërkombëtar.

Neni 8

1) Administrata e shtetit të origjinës mundet që në bazë të parashikimit të vet ta vërtetojë dhe ta paguajë në dobi të saj taksën nacionale e cila do të kërkojë nga bartësi i të drejtës së markës tregtare për të cilën kërkohet regjistrim ndërkombëtar apo ripërtëritje.

2) Regjistrimi i një marke tregtare pranë Byrosë ndërkombëtare është i kushtëzuar me pagesën paraprake të taksës ndërkombëtare e cila përfshinë:

a) taksën bazë;

b) taksën plotësuese për çdo klasë përmes tri klasave nga klasifikimi ndërkombëtar në të cilën janë të vendosura produktet dhe shërbimet për të cilat zbatohet marka tregtare;

c) shtesë në taksën në rast të çdo kërkese për zgjerim të mbrojtjes në kuptim të nenit 3 ter.

3) Megjithatë, në rast se numri i klasave të produkteve dhe shërbimeve është vërtetuar apo kontestuar nga ana e Byrosë ndërkombëtare, taksë plotësuese nga pika 2 b) do të mund të paguhet në afat të përcaktuar me rregulloren për përmbarim, pa pasur ndikim në datën e regjistrimit. Nëse taksa plotësuese nuk paguhet deri në skadimin e afatit të paraparë, respektivisht nëse paraqitësi nuk e kufizon listën e produkteve apo shërbimeve në masën e nevojshme, do të konsiderohet se fletëparaqitja për regjistrim ndërkombëtar është braktisur.

4) Byroja ndërkombëtare do ti shpërndajë shumat vjetore nga të ardhurat nga regjistrimi ndërkombëtar, përveç atyre të parapara me pikën 2 nën b) dhe c), në pjesë të njëjta midis shteteve anëtare të këtij akti, prej ku do të hiqen harxhimet e përbashkëta dhe ngarkesat e shkaktuara me zbatimin e aktit në fjalë. Nëse, në momentin e hyrjes në fuqi të këtij akti një shtet ende nuk e ka ratifikuar apo nuk e ka nënshkruar, ai, deri në ditën e hyrjes në fuqi të ratifikimit apo qasjes, do të ketë të drejtën e shpërndarjes së tepricës së të ardhurave të përlllogaritura në bazë të aktit të mëparshëm që zbatohet në të.

5) Shumat që rrjedhin nga taksat plotësuese të parapara me pikën 2 nën b), pas kalimit të çdo viti do të iu ndahet shteteve anëtare të këtij akti apo të Aktit të

Niqes nga 15 qershori i vitit 1957, në mënyrë të barabartë sipas numrit të markave tregtare për të cilat mbrojtja është kërkuar në secilën prej tyre në vitin e kaluar, kurse nëse ka të bëjë me shtetet të cilat bëjnë hulumtim paraprak, numri i fituar do të korrigjohet me një koeficient i cili do të përcaktohet me rregulloren për përmbarrim. Nëse në momentin e hyrjes në fuqi të ratifikimit apo të qasjes.

6) Shumat që rrjedhin nga shtesat e taksave të parapara me pikën 2 nën c), do të u shpërndahen shteteve të cilat kanë shfrytëzuar mundësitë e parapara me nenin 3 bis sipas dispozitave në pikën 5. Nëse në momentin e hyrjes në fuqi të këtij akti një shtet ende nuk e ka ratifikuar apo nuk ka aderuar drejt tij, ai do të ketë të drejtën e shpërndarjes së shumës së përlllogaritur sipas Aktit të Niqes deri në ditën e hyrjes në fuqi të ratifikimit apo aderimit.

Neni 8 bis

Bartësi i të drejtës së markës së regjistruar tregtare ndërkombëtare çdo herë mund të heqë dorë nga mbrojtja në një apo më shumë shtete kontraktuese, me deklaratë të dorëzuar në administratën e shtetit të tij për shkak të dorëzimit deri te Byroja ndërkombëtare, e cila do të ua komunikojë këtë shteteve për të cilat ka të bëjë ajo heqje dorë. Kjo deklaratë nuk nënkupton asnjë taksë.

Neni 9

1) Administrata e shtetit të bartësit të së drejtës, gjithashtu, do ti dorëzojë Byrosë ndërkombëtare anulime, fshirje, refuzim, bartje dhe ndryshime të tjera të cilat kanë të bëjnë me përshkrimin e markës tregtare të mbrojtur në regjistrin ndërkombëtar, nëse ato ndryshime kanë të bëjnë edhe me regjistrimin ndërkombëtar.

2) Byroja ndërkombëtare do ti shkruajë këto anulime, fshirje etj. në regjistrin ndërkombëtar, do të ua dorëzojë administratave të shteteve kontraktuese dhe do ti publikojë në listën e saj.

3) Gjithashtu kështu do të veprohet kur bartësi i të drejtës së markës së regjistruar tregtare ndërkombëtare do të kërkojë që të kufizohet lista e produkteve apo shërbimeve në bazë të së cilave ky regjistrim zbatohet.

4) Këto veprime mund të kushtëzohen me pagesën e taksës speciale, e cila përcaktohet me rregulloren për përmbarrim.

5) Shtimi i mëvonshëm i ndonjë produkti apo shërbimi në listë do të mund të sigurohet vetëm me dorëzimin e fletëparaqitjes së re në pajtim me dispozitat e nenit 3.

6) zëvendësimi i një produkti apo shërbimi me produkt apo shërbim tjetër do të konsiderohet si shtesë.

Neni 9 bis

1) Kur marka tregtare, e shënuar në regjistrin ndërkombëtar, do të bartet në person tjetër banues në shtet tjetër kontraktues, e jo në shtetin bartës i së drejtës së markës së regjistruar tregtare, kjo bartje do ti komunikohet Byrosë ndërkombëtare nga ana e administratës së këtij shteti të fundit. Byroja ndërkombëtare do ta shënojë bartjen, do të ua komunikojë administrative të tjera dhe do ta publikojë në gazetën e vet. Nëse bartja është kryer para skadimit të afatit prej pesë viteve, duke filluar nga dita e regjistrimit ndërkombëtar, Byroja ndërkombëtare do të kërkojë pajtim nga administrata e shtetit të bartësit të ri të së drejtës dhe do ti publikojë, nëse kjo është e mundur, datën dhe numrin e markës së regjistruar tregtare në shtetin e bartësit të ri të së drejtës.

2) Nuk do të shënohet asnjë bartje e markës tregtare e cila është e shënuar në regjistrin ndërkombëtar, ekzekutuar në dobi të personit i cili nuk është i autorizuar që të paraqesë markë tregtare ndërkombëtare.

3) Nëse nuk ka qenë e mundur që ndonjë bartje të shënohet në regjistrin ndërkombëtar, pa marrë parasysh se shteti i bartësit të ri të së drejtës refuzon të japë pajtim, apo sepse është ekzekutuar në dobi të personit i cili nuk është i autorizuar të kërkojë regjistrim ndërkombëtar, administrata e shtetit të bartësit të mëparshëm do të ketë të drejtë të kërkojë nga Byroja ndërkombëtare ta fshijë markën tregtare nga regjistri i saj.

Neni 9 ter

1) Nëse Byrosë ndërkombëtare i komunikohet bartje e markës tregtare ndërkombëtare vetëm për një pjesë të produkteve apo shërbimeve të regjistruara, të njëjtën do ta shkruajë në regjistrin e saj. Çdo shtet kontraktues do të ketë mundësi që të mos pranojë bartje të tillë, nëse produktet apo shërbimet e përfshira në pjesën e tillë që bartet janë të ngjashme me ato për të cilat marka tregtare mbetet edhe më tutje e regjistruar në dobi të bartësit.

2) Gjithashtu, Byroja ndërkombëtare do të kryejë regjistrim të bartjes së markës tregtare ndërkombëtare vetëm për një apo më shumë shtete kontraktuese.

3) Nëse në rastet e mëparshme ndodh ndryshim I shtetit bartës I së drejtës, administrata të cilës I takon bartësi I ri I së drejtës duhet patjetër të japë pajtimin e saj I cili kërkohet në pajtim me nenin 9 bis, nëse marka tregtare ndërkombëtare është bartur para kalimit të afatit prej pesë viteve, duke numëruar prej ditës së regjistrimit ndërkombëtar.

4) Dispozitat nga pikat e lartpërmendura do të zbatohen vetëm me rezervë në raport me nenin 6 quarter të Konventës së Parisit për mbrojtje të pronësisë industriale.

Neni 9 quater

1) Nëse shumica e shteteve të Unionit të veçantë pajtohet që të realizojnë unifikim të ligjeve të tyre kombëtare për markat tregtare, do të mund ta njoftojnë qeverinë e konfederatës zvicerane:

a) se administratat nacionale e secilës prej tyre do të zëvendësohet me një administratë të përbashkët, dhe

b) se territoret e tyre përkatëse do të konsiderohen si një shtet i vetëm sa i përket zbatimit, në tërësi apo pjesërisht të dispozitave të cilat i paraprijnë këtij neni.

2) Ky njoftim do të hyjë në fuqi pas gjashtë muajsh nga dita kur drejtori gjeneral do ti njoftojë shtetet e tjera kontraktuese për këtë.

Neni 10

1)a) Unioni i veçantë ka Kuvendin e formuar nga shtetet të cilat e kanë ratifikuar këtë akt apo kanë aderuar në të.

b) Qeverinë e çdo shteti e përfaqëson një përfaqësues, të cilit mund ti ndihmojë zëvendësit, këshilltarët dhe ekspertët.

c) Shpenzimet e çdo përfaqësimi i bartë qeveria e cila e ka emëruar, përveç shpenzimeve të rrugës dhe qëndrimit për një deputet nga çdo shtet anëtar, të cilat janë barrë e Unionit të veçantë.

2)a) Kuvendi:

(a) I diskuton të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me mirëmbajtjen dhe zhvillimin e Unionit të veçantë dhe të zbatimit të kësaj marrëveshjeje;

(b) I jep udhëzime Byrosë ndërkombëtare për përgatitjen e konferencave për revizion, duke mbajtur llogari me kujdes për vërejtjet e shteteve të Unionit të veçantë të cilat këtë akt nuk e kanë ratifikuar apo nuk kanë aderuar në të;

(c) e ndryshon Rregulloren për përmbarim dhe I vërteton shumat e taksave të caktuara në nenin 8 pika 2, si dhe taksat e tjera të cilat kanë të bëjnë me regjistrimin ndërkombëtar;

(ç) I hulumton dhe i miraton raportet dhe punën e drejtorit gjeneral që kanë të bëjnë me Unionin e veçantë dhe ia jep të gjitha udhëzimet e dobishme për është që janë në kompetencë të Unionit të veçantë;

(d) e sjell programin, e miraton buxhetin tre vjeçar të Unionit të veçantë dhe i miraton llogaritë e saja përfundimtare;

(dh) e miraton rregulloren financiare të Unionit të veçantë;

(e) i formon bordet e ekspertëve dhe grupet punuese të cilat konsiderohen si të dobishme për realizimin e qëllimeve të Unionit të veçantë;

(f) vendos se cilat nga shtetet të cilat nuk janë anëtare të Unionit të veçantë dhe cilat organizata ndërqeveritare dhe ndërkombëtare joqeveritare mund të marrin pjesë në mbledhjet e saj në cilësinë e vëzhguesit;

(g) I miraton ndryshimet e neneve prej 10 deri në 13;

(h) ndërmerri gjithçka që është adekuate për realizimin e detyrave të Unionit të veçantë;

(i) I kryen të gjitha punët e tjera që dalin nga kjo marrëveshje.

2)b) Kuvendi vendos për çështjet për të cilat në mënyrë të barabartë janë të interesuara edhe unione të tjera me të cilat Organizata menaxhon, prej kur do të njoftohet me mendimin e Bordit Koordinues të Organizatës.

3)a) Çdo shtet anëtarë i Kuvendit disponon me një vote.

b) Kuorumin e përbëjnë gjysma e shteteve anëtare të Kuvendit.

c) edhe krahas përcaktimit në pikën b), nëse gjatë ndonjë mbledhjeje numri i shteteve të përfaqësuara është më mi vogël se gjysma apo i barabartë apo më i madh se një e treta e shteteve anëtare të Kuvendit, ajo mund të sjellë vendime; megjithatë, vendimet e Kuvendit, përveç atyre të cilat kanë të bëjnë me veprimin e tij, do të bëhet të përmbarueshme atëherë kur do të plotësohen kushtet që janë theksuar më poshtë. Byroja ndërkombëtare do ti njoftojë këto vendime shteteve anëtare të Kuvendit të cilat nuk kanë qenë të përfaqësuara, duke i ftuar që të deklarohen me shkrim, në afat prej tre muajsh nga dita e këtij njoftimi, të japin votën e tyre apo të përmbahen. Nëse pas skadimit të këtij afati numri i shteteve të cilat në këtë mënyrë e kanë dhënë votën e tyre apo janë përmbajtur është më së paku i barabartë me numrin e shteteve që kanë munguar që të arrihet kuorumi gjatë mbledhjes, këto vendime do të bëhen të përmbarueshme me kusht që në të njëjtën kohë të jetë arritur shumica e nevojshme.

ç) përveç në rastet nga neni 13 pika 2, Kuvendi sjell vendime me shumicë prej dy të tretave nga votat e dhëna.

d) përmbajtja nuk konsiderohet si votë.

dh) një deputet mund të përfaqësojë vetëm një shtet dhe mund të votojë vetëm në emër të saj.

e) shtetet e Unionit të veçantë të cilat nuk janë anëtare të Kuvendit mund të marrin pjesë në mbledhjet e tij vetëm në cilësinë e vëzhguesit.

4)a) Kuvendi mblidhet në séance të rregullta një here në tri vite me thirrjen e drejtorit gjeneral dhe, përveç në rastet e jashtëzakonshme, në të njëjtën kohë dhe në vendin e njëjtë si Kuvendi i Përgjithshëm i Organizatës.

b) Kuvendi mblidhet në séance të jashtëzakonshme me ftesë të drejtorit gjeneral, e me kërkesë të një të katërtave të shteteve anëtare të Kuvendit.

c) Drejtori gjeneral e përgatit rendin e ditës për çdo seancë.

5) Kuvendi e miraton rregulloren e vet.

Neni 11

1) a) Byroja ndërkombëtare i kryen punët të cilat kanë të bëjnë me regjistrimin ndërkombëtar, si edhe punët e tjera administrative.

b) Byroja ndërkombëtare në mënyrë të veçantë i përgatitë mbledhjet dhe i kryen punët e sekretariatit të Kuvendit dhe bordit të ekspertëve dhe grupeve punuese të cilat mund ti formojë.

c) Drejtori gjeneral është funksionari më i lartë i Unionit të veçantë i cili edhe e përfaqëson atë.

(2) Drejtori gjeneral dhe të gjithë anëtarët e personelit që ai do ti caktojë marrin pjesë pa të drejtë vote, në të gjitha seancat e Kuvendit, Bordit të ekspertëve, si edhe çdo bordi tjetër të ekspertëve apo grupi punues që mund ta formojë Kuvendi apo Bordi i ekspertëve. Drejtori gjeneral ose një anëtar i personelit që ai e cakton sipas detyrës zyrtare është sekretar i këtyre organeve.

(3) (a) Sipas udhëzimeve të Kuvendit, Byroja ndërkombëtare i përgatitë konferencat për revizion të dispozitave të Marrëveshjes, përveç në rastet e nëneve 10 deri 13.

(b) Për përgatitjen e konferencave për revizion, Byroja ndërkombëtare mund të këshillohet me organizatat qeveritare dhe ndërqeveritare ndërkombëtare.

(c) Drejtori gjeneral dhe personat që ai do ti caktojë, në debatet e këtyre konferencave marrin pjesë pa të drejtën e votës.

(4) Byroja ndërkombëtare i kryen të gjitha detyrat e tjera të cilat i janë besuar.

Neni 12

1) a) Unioni i veçantë ka buxhetin e vet.

(b) Buxheti i Unionit të veçantë i përfshinë të ardhurat dhe shpenzimet e Unionit të veçantë, kontributin e tij për buxhetin e shpenzimeve të përbashkëta të Unionit, si dhe në rast nevojë, shumën e vendosur në shërbim të buxhetit në konferencën e Organizatës.

(c) Si shpenzime të përbashkëta të Unionit konsiderohen shpenzimet që nuk i takojnë vetëm Unionit të veçantë, por gjithashtu njëres apo më shumë unioneve që i menaxhon Organizata. Pjesëmarrja e Unionit të veçantë në këto shpenzime të përbashkëta është proporcionale me dobitë e saj nga këto shpenzime

2) Buxheti i Unionit të veçantë miratohet duke mbajtur llogari për nevojat për bashkëpunim me buxhetet e unioneve të tjera që i menaxhon Organizata.

3) Buxheti i Unionit të veçantë financohet nga këto burime:

(a) taksat bazë dhe taksat e tjera në lidhje me regjistrimin ndërkombëtar dhe taksa dhe shuma të cilat janë borxh në emër të shërbimeve që Byroja ndërkombëtare i ofron në emër të Unionit të veçantë;

(b) të ardhurat nga shitja e botimeve të Byrosë ndërkombëtare që kanë të bëjnë me Unionin e veçantë dhe të drejtat që dalin nga këto publikime;

(v) dhuratat, donacionet dhe subvencionet;

ç) qiratë, kamatat dhe të ardhurat e tjera të ndryshme.

4) a) Shumën e taksave të theksuara në nenin 8 pika 2 dhe taksat e tjera në lidhje me regjistrimin ndërkombëtar i përcakton Kuvendi me propozim të drejtorit gjeneral.

b) Kjo shumë përcaktohet ashtu që të ardhurat e Unionit të veçantë të cilat rrjedhin nga taksat, përveç taksave plotësuese dhe shtesat e taksave nga neni 8 pika 2 nën b) dhe c), si edhe nga burime të tjera duhet të mbulojnë shpenzimet e Byrosë ndërkombëtare për Unionin e veçantë.

c) Nëse buxheti nuk është miratuar para fillimit të vitit të ri buxhetor, do të vazhdojë buxheti nga viti paraprak në mënyrë të paraparë me rregulloren financiare.

5) Me përjashtim të dispozitave nga pika 4 nën a), lartësia e taksave dhe shumave të cilat paguhen për shërbimet që i ofron Byroja ndërkombëtare në emër të Unionit të veçantë, i përcakton drejtori gjeneral, i cili për këtë i dorëzon raport Kuvendit.

6) a) Unioni i veçantë disponon me fond të punës i cili formohet nga pagesa e vetme e çdo vendi të Unionit të veçantë. Nëse fondi bëhet i pamjaftueshëm, Kuvendi vendos për rritjen e tij.

(b) Shuma e pagesës fillestare të çdo vendi në fondin e theksuar apo pjesëmarrja e tij në rritjen e tij janë në proporcion me kontributin e këtij vendi për vitin gjatë të cilit formohet fondi apo vendoset për rritjen.

(c) Kuvendi e përcakton proporcionin dhe mënyrën e pagesës me propozim të drejtorit gjeneral, sipas mendimit të marrë paraprak nga Këshilli koordinues i Organizatës.

ç) Derisa zgjatë autorizimi i Kuvendit që fondi rezervë i Unionit të veçantë të shfrytëzohet si fond pune, Kuvendi mund të ndërpresë zbatimin e dispozitave të nënpikave a), b) dhe c).

7) a) Në marrëveshjen për selinë, të lidhur me vendin në territorin e së cilit Organizata ka selinë e saj, parashihet që ky vend të japë paradhënie nëse fondi punues është i pamjaftueshëm. Shuma e këtyre paradhënies dhe kushtet nën të cilat miratohen ato, janë objekt në çdo rast të veçantë, në marrëveshje të veçanta midis vendit për të cilin bëhet fjalë dhe organizatës.

b) Vendi nga dispozita (a) dhe Organizata kanë, secila për vete, të drejtë që ta anulojnë detyrimin për miratimin e paradhënies në rrugë me shkrim në formë të njoftimit. Heqja dorë hyn në fuqi tre vjet pas kalimit të vitit në të cilin është njoftuar. .

8) Vlefshmëri të llogarive kryejnë, në mënyrat e parapara me rregulloren financiare, një apo më shumë vende të Unionit të veçantë apo kontrollorë të jashtëm të cilët, me pajtimin e tyre i emëron Kuvendi.

Neni 13

1) Propozime për ndryshime të neneve 10,11 dhe 12 dhe të këtij neni mund të sjellë çdo vend anëtarë i Unionit të veçantë apo drejtori gjeneral. Ky i fundit i njofton këto propozime të vendeve anëtare të Unionit të veçantë më së paku gjashtë muaj para se të sillen në Kuvend për tu shqyrtuar. .

2) Çdo ndryshim të neneve nga dispozita 1 e miraton Kuvendi. Për miratim është e nevojshme shumica prej tre të katërtave të votave të dhëna. Megjithatë, për çdo ndryshim të nenit 10 dhe të kësaj dispozite është e nevojshme shumica prej katër të pestave të votave të dhëna.

3) Çdo ndryshim i neneve nga dispozita 1 hyn në fuqi një muaj nga dita kur drejtori gjeneral do të pranojë nga tre të katërtat e vendeve që janë anëtare të Unionit të veçantë, në momentin kur është miratuar ndryshimi, njoftime me shkrim për pranimin, në pajtim me rregullat e tyre adekuate kushtetuese. Çdo ndryshim i këtillë i miratuar i këtyre neneve i obligon të gjitha vendet anëtare të Unionit të veçantë në momentin kur ndryshimi do të hyjë në fuqi, apo ato që do të bëhen anëtare më vonë.

Neni 14

1)a) Çdo shtet i Unionit të veçantë i cili e ka nënshkruar këtë akt mund ta ratifikojë, e nëse nuk e ka nënshkruajë mund të aderojë në të.

2)a) Çdo shtet jashtë Unionit të Parisit, kurse palë kontraktuese e Konventës së Parisit për mbrojtje të pronësisë industriale, mund të aderojë në këtë akt dhe të bëhet anëtare e Unionit të veçantë.

b) Kur Byroja ndërkombëtare do të njoftohet se njëra prej atyre shteteve ka aderuar në këtë akt, ajo, në pajtim me nenin 3, do i dorëzojë administratës së atij shteti njoftim gjithëpërfshirës për të gjitha markat tregtare të cilat deri në atë moment gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare.

c) Me njoftim e këtillë taksave në fjalë u sigurohen përfitimet nga dispozitat e mëparshme në territorin e atij shteti dhe fillon të rrjedhë afati prej një vitit në të cilin administrata për të cilën bëhet fjalë mund të japë deklaratë të paraparë me nenin 5.

ç) Megjithatë, duke aderuar në këtë akt, ai shtet mund të deklarojë se zbatimi i këtij akti kufizohet në markat tregtare të cilat janë të regjistruara duke filluar nga dita kur aderimi hyn në fuqi, përveç për markat tregtare ndërkombëtare të cilat prej më herët janë lëndë e regjistrimit ekuivalent në atë shtet që ka ende vlerë dhe të cilat, me kërkesë të të interesuarve, pranohen menjëherë.

d) Kjo deklaratë e liron Byronë ndërkombëtare nga dorëzimi i njoftimit gjithëpërfshirës të lartpërmendur. Kjo kufizohet në njoftim për markat tregtare për të cilat ka pranuar kërkesë, me të dhënat e nevojshme, në afat prej një viti nga dita

e aderimit të shtetit të ri që të iu ofrojë dobi në përjashtimin e paraparë me pikën d).

dh) Byroja ndërkombëtare nuk ju dorëzon njoftime gjithëpërfshirëse atyre shteteve të cilat gjatë aderimit në këtë akt deklarojnë se do të shfrytëzojnë mundësinë e nenin 3 bis. Përveç kësaj, këto shtete mund që në të njëjtën kohë të deklarojnë de zbatimi i këtij akti do të kufizohet vetëm për markat tregtare të regjistruara duke filluar nga dita kur aderimi i tyre hyn në fuqi; megjithatë, ky kufizim nuk ka të bëjë me ato marka tregtare ndërkombëtare të cilat në atë shtet veç më kanë qenë lëndë e regjistrimit ekuivalent kombëtar dhe të cilat mund të qojnë deri te njoftimi për zgjerimin e mbrojtjes të bëra dhe njoftuara në pajtim me nenet 3 ter dhe 8, dispozita 2 pika c).

e) Konsiderohet se regjistrimi i markave tregtare të cilat janë lëndë e njoftimeve të parapara me këtë dispozitë, zëvendësojnë regjistrim i cili është kryer drejtpërdrejtë në shtetin e ri kontraktues para ditës së aderimit të tij.

4)a) Sa u përket pesë shteteve të cilat të parat i kanë deponuar instrumentet e tyre për ratifikim apo për aderim, ky akti hyn në fuqi tre muaj pas deponimit të këtyre instrumenteve të shtetit të pestë.

b) Në raport me çdo shtet tjetër ky akt hyn në fuqi tre muaj pas ditës kur ratifikimin apo aderimin e tij e publikon drejtori gjeneral, përveç kur në instrumentin për ratifikim apo aderim nuk është përcaktuar ndonjë datë e mëvonshme. Në rastin e fundit, ky akt hyn në fuqi saktë në ditën e përcaktuar në raport me atë shtet.

5) Ratifikimi apo aderimi tërheqë anëtarësim të plotë të të gjitha dispozitave dhe fitim të të gjitha përparësive të cilat ky akti i përcakton.

6) Pas hyrjes në fuqi të këtij akti, asnjë shtet nuk mund ti qaset Aktit të Niqes nga 15 qershori i vitit 1957, përveç bashkërisht me ratifikimin e këtij akti apo me aderimin në të. Aderimi në aktet të cilat janë miratuar më herët se Akti i Niqes nuk pranohet, madje as bashkë me ratifikimin apo aderimin në këtë akt.

7) Në këtë marrëveshje zbatohen dispozitat nga neni 24 i Konventës së Parisit për mbrojtje të pronësisë industriale.

Neni 15

1) Ky akt mbetet në fuqi në kohë të pakufizuar.

2) Çdo shtet mund ta anulojë këtë akt në rrugë të lajmërimit të dorëzuar deri te drejtori gjeneral. Ky anulim parasheh heqje dorë nga të gjitha aktet e mëparshme, kurse ka ndikim vetëm në shtetin që e ka bërë anulimin, derisa marrëveshja mbetet në fuqi dhe zbatohet në raport me shtetet e tjera të Unionit të veçantë.

3) Heqja dorë hyn në fuqi një vit pas ditës kur drejtori gjeneral e ka pranuar njoftimin.

4) Me mundësinë për heqjen dorë të paraparë me këtë nen nuk mund të përfitojë shteti para skadimit të pesë viteve nga dita kur është bërë anëtare e Unionit të veçantë.

5) Markat tregtare ndërkombëtare të regjistruara para ditës kur heqja dorë ka hyrë në fuqi, e të cilat nuk janë refuzuar në vitin e paraparë me nenin 5, vazhdojnë të gëzojnë mbrojtje si të jenë të lajmëruara në atë shtet drejtpërsëdrejti për gjatë gjithë kohëzgjatjes së mbrojtjes ndërkombëtare.

Neni 16

1)a) Në raportet midis shteteve anëtare të Unionit të veçantë të cilat e kanë ratifikuar apo kanë aderuar në të, ky akti i zëvendëson, duke filluar nga dita kur për to do të hyjë në fuqi, tekstet e Marrëveshjes së Madritit nga viti 1891 dhe ato të cilat i kanë paraprirë këtij akti.

b) Megjithatë çdo shtet i Unionit të veçantë i cili e ka ratifikuar këtë akt apo ka aderuar në të, ka për obligim në bazë të teksteve të mëparshme, të cilat paraprakisht i ka anuluar në kuptimin e nenit 12 dispozita 4 i Aktit të Niqes nga 15 qershori i vitit 1957, në raportet e saja me shtetet të cilat nuk e kanë ratifikuar këtë akt apo nuk kanë aderuar në të.

2) Shtetet jashtë Unionit të veçantë të cilat do të bëhen palë kontraktuese të këtij akti e zbatojnë në regjistrimet ndërkombëtare të bëra në Byronë ndërkombëtare me ndërmjetësim të administratës kombëtare të çdo shteti anëtar i Unionit të veçantë i cili nuk është palë kontraktuese e këtij akti nën kushtin që këto regjistrime ti kënaqin, për këto shtete, kushtet të cilat ky akt i përcakton. Sa i përket regjistrimit ndërkombëtar të bërë në Byronë ndërkombëtare me ndërmjetësim të administratës kombëtare të këtyre shteteve jashtë Unionit të veçantë të cilat do të bëhen palë kontraktuese të këtij akti, ato pajtohen që shteti për të cilën u bë fjalë më lartë, të kërkojë plotësim të kushteve të parapara me aktin më të ri palë e së cilit është.

Neni 17

1)a) Ky akt është nënshkruar në një kopje në gjuhë franceze dhe është deponuar në Qeverinë e Suedisë.

b) Drejtori gjeneral, pas këshillimit me qeveritë e interesuara, do të përpilojë tekste zyrtare në gjuhë të tjera të cilat i cakton Kuvendi.

2) Ky akt mbetet i hapur për aderim në Stokholm, deri më 13 janar të vitit 1968.

3) Dy transkripto të tekstit të këtij akti të nënshkruar , të besuar nga Qeveria e Suedisë, drejtori gjeneral do të ua dorëzojë qeverive të të gjitha shteteve të Unionit të veçantë, e me kërkesë, edhe qeverisë së çdo shteti tjetër.

4) Drejtori gjeneral do ta regjistrojë këtë akt në Sekretariatën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

5) Drejtori gjeneral i njofton qeveritë e të gjitha shteteve anëtare të Unionit të veçantë për nënshkrimin, deponimin e instrumenteve për ratifikim apo aderim dhe për deklaratat të cilat këto instrumente i përmbajnë, hyrjen në fuqi të të gjitha dispozitave të këtij akti, njoftimin për heqjen dorë në lidhje me zbatimin e neneve 3 bis, 9 quarter, 13, 14 dispozita 7, dhe 15 dispozita 2.

Neni 18

1) Deri në marrjen e postit të drejtorit të parë gjeneral, konsiderohet se gjithçka që përmendet në këtë akt, për Byronë ndërkombëtare të Organizatës apo për drejtorin gjeneral kanë të bëjnë me Byronë e unionit e themeluar me Konventën e Parisit për mbrojtje të pronësisë industriale, respektivisht drejtorin e saj.

2) Shtetet e Unionit të veçantë të cilat nuk e kanë ratifikuar këtë akt apo nuk kanë aderuar në të mund, gjatë pesë viteve nga hyrja në fuqi e Konventës për themelimin e Organizatës, të përfitojnë nëse duan, me të drejtat e parapara me nenet 10 dhe 13 të këtij akti, sikur të jenë të lidhura me këto nene. Çdo shtet i cili dëshiron të përfitojë me këto të drejta, për këtë qëllim, dorëzon deri te drejtori gjeneral njoftim me shkrim, i cili hyn në fuqi në ditën e pranimit. Për këto shtete konsiderohet se janë anëtare të Kuvendit pas kalimit të kësaj periudhe.

Në vërtetim nënshkruesit, për këtë autorizim të caktuar, e nënshkruan këtë akt.

Përpiluar më 14 qershor të vitit 1967 në Stokholm.